



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the
General Secretary

DATË/A:	12.07.2019
REFERENC-Ë:	2758/19 ZSP 1809/ARPL 2019
PËR/ZA/TO:	"CONTOUR GLOBAL KOSOVO" L.L.C." Rr. Anton Çeta 5A Prishtinë, Kosovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM

Sipas kërkesës tuaj me nr. të protokollit: 2758/19, organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar lëndën dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letër përcjellëse :

"Me respekt"



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

Bazuar në nenin 71 të Ligjit Nr.04/L-147 dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L- 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga “Contour Global Kosovo” L.L.C., Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerrë këtë:

Pëlqim Ujor

APROVOHET kërkesa e palës “Contour Global Kosovo” L.L.C., Rr. Anton Çeta, 5A Prishtinë Kosovë për Pëlqim Ujore, lidhur me shfrytëzimin e ujit nga kanali i kryesor “Iber-Lepenc” për Termocentralin “Kosova e Re”, me kapacitet të paraparë instalues 450 ± 20 MW sipas projektit, nën kushtet si në vijim:

1. Të prezantohet Studimi – Analiza e shfrytëzimit të ujit, sipas specifikave për veprimtarinë përkatëse, të zgjedhur në formën analitike dhe grafike për sasinë e nevojshme të shfrytëzimit;
 - Uji për përdorim industrial – teknologji, për Termocentralin “Kosova e Re”
 - Uji për shfrytëzim, për nevoja të ndërtesës së dministratës etj;
2. Të prezantohet, Leja për kyçje e operatorit të përcaktuar të sistemit të ujësjellësit, respektivisht kanalizimit, nëse pala pretendon të kyçet;
3. Pala detyrohet ti kompenzojë dëmet e shkaktuara personave të tretë gjatë zhvillimit të punimeve, në kohën e validitetit të pëlqimit ujor;

Faqe 2 nga 4



4. Pala obligohet të mbaj evidencë për ujin e shfrytëzuar, sipas njehësorëve të vendosur në kyçje të kanalit kryesor, si dhe në çdo hyrje të distribuimit të tijë, për veprimtarin përkatëse. Nr. serik i njehësorit përkatës evidentohet, dhe sipas tijë mbahet evidenca e rregullt, sipas standardeve në fuqi.
5. Raporti në formë tabelare duhet të përmbajë të gjitha të dhënat e shfrytëzimit të evidentuara përmes njehësorëve, dhe për çdo gjasht muaj, ti dërgoj në sistemin informativ të ujërave;
6. Pala për variantet tjera të mundëshme, për shfrytëzim të ujit nga burimet tjera (Lumi Llap etj), duhet të aplikoj, sipas të gjitha procedurave për Leje Ujore, sipas legjislacionit aktual për Ujërat e Kosovës;
7. Pala pas pranimit teknik të TC-Kosova, sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, duhet të aplikoj për Leje Ujore, për shfrytëzim të ujit me dokumentacionin e bashkangjitur si në vijim:

Aplikacionit për leje ujore duhet bashkangjitur:

- 1.1. Dokumentacionin përkatës të pranimit teknik;
- 1.2. Kopjen e vendimit të lëshimit të Lejës Ndërtimore të lëshuar nga Organi Kompetent;
- 1.3. Kopja e vendimit të Pëlqimit Ujor;
- 1.4. Projektin kryesor dhe zbatues të TC – “ Kosova a Re”;

ARSYETIM

Pala „CONTOUR GLOBAL KOSOVO”, L.L.C., K. Prishtinë, pas kushteve ujore, me Nr. :6184-2/18 –ZSP- 14, Datë:22.01.2019, ka sjellë dokumentacion për Pëlqim Ujor për shfrytëzimin e ujit për Termocentralin Kosova e Re, nga Kanali, Iber – Lepencit, Hidrosistemi që rrjedhë nga Liqeni i Ujëmanit (Gazivodës), deri në qytetin e Prishtinës. Aplikuesi kërkesës ia ka bashkangjitur këtë dokumentacion investivo-teknik:

- Aplikacionin për pëlqim ujor;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit, “Contour Global Kosovo” L.L.C. ;
- Informimin nga “Contour Global Kosovo” L.L.C. për kontratën me “Eco-Illiria” për aplikim për Kushte Ujore dhe dhe Pëlqim Ujor për TC “Kosova e Re “ për shfrytëzime të ujit;
- Plani i situacionit, me përpjesë 1:1000 , punuar nga Izjah Qerkini , inxh i gjeod. , vërtetuar nga Rustem BEKAJ , Departamenti i i Gjeodezisë Inxhinierike – KEK;
- Orto foto me prezantimin e kanalit të ujit të I-L dhe Koridorit furnizues të ujit;
- Raporti i projektimit ideor për kushte ujore;



- Ekstrakt nga Certifikata – personi KEK – Sh.a.
- Diploma dhe CV e personit hartues, Inxh i Dipl i Nder. Drejtimi hidro, znj Violeta HOXHA;
- Projekti i Termocentralit Kosova e Re, bllok me linjit 450 ± 20MW
- Marrëveshjen në mes të “Contour Global” dhe “Iber Lepenci” (19 Shkurt 2018)
- CD-në.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko – investiv për Pëlqim Ujor të parashtruar nga „Contour Global Kosovo” L.L.C., K. Prishtinë, lidhur me shfrytëzimin e ujit e nga kanali kryesor i Iber Lepencit për Termocentralin Kosova e Re.

Bazuar në rëndësin e projektit me interes nacional- Termocentralit “Kosova e Re”, Miratimeve nga palët e interesit, përmes Marrëveshjeve të nevojshme për këtë projekt, shikimit në vend, 02.11.2018, bazuar në vendimet paraprake të lëshuara nga organet kompetente, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:

Pala e paknaqur, ka të drejtë në inicimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr: 2758/19

- ZSP- 809/ Datë: 16.07.2019

Prishtinë

T’i dërgohet :

1. Palës,
2. Kabinetit të Ministrit,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. K. Obiliq,
5. Inspektoratit,
6. ARPL-së,
7. Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm



Arben ÇITAKU

Faqe 4 nga 4

Adresa: ish Pallati i Mediave, kati 14-17, 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon/Faks: + 381 38 517 638; +381 38 517 558

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net